



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 200 Më 21.01 2020
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

RAPORT VJETOR

2019



PËRMBAJTJA

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars	1
Tremujori i dytë: prill, maj, qershor	2
Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator	3
Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor.....	5
<i>Biblioteka "Sulejman Krasniqi"</i>	8
Përfundim.....	9

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për gjatë vitit 2019, ka përfunduar me sukses të gjitha aktivitetet të planifikuara në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve, duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale kulturore, sportive e rinore të Komunës së Rahovecit.

- Në raport të punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekte, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.
- Personeli i DKRS-së përgjatë vitit 2019, është angazhuar që të gjitha këto aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.
- Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2019. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë vitit 2019, ka përfunduar me sukses të gjitha aktivitetet e planifikuara në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve, duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale kulturore, sportive e rinore të Komunës së Rahovecit.

Çfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmbledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në dhjetor të vitit 2019. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Në tre muajt e parë të vitit 2019, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, janë realizuar shumë takime me partnerë dhe palë të jashtme, ku jemi përkushtuar maksimalisht në arritjen e objektivave në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmbushur planin e punës.

- Duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e shumta për sigurim të transportit për klube sportive dhe OJQ-ve rinore e kulturore, për zhvillimin e aktiviteteve të tyre në përgjithësi, si DKRS shumicën e kërkesave i kemi aprovuar, duke ju siguruar mjete transportuese për realizim të aktiviteteve të tyre, që janë në pajtim me politikat programore të drejtorisë.
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara nga viti paraprak,
- Përgatitja e planit të prokurimit për projektet kapitale,
- Përgatitja e specifikacionit të tenderit "Rekuizita për nevojat e komunës".
- Organizime të ndryshme për nder të manifestimit përkujtimor dhe kulturor "Flaka e Janarit 2019": Formimi i Këshillit Organizues, shpallja e konkursit për art letrar, pamor dhe film dokumentar me metrazh të shkurtër, formimi i komisionit për verifikimin e aplikimeve në konkurs, organizimi i ekspozitës, si dhe realizimi i manifestimit qendror, "Flaka e Janarit" në Qendrën e Kulturore "Mensur Zyberaj" në Rahovec.
- Shfaqje teatrale në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj", në bashkëpunim me Teatrin e Qytetit të Prizrenit, me temë "Iku autobusi".

- Shënimi i ditës së 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, me aktivitete të ndryshme kulturore e artistike: Formimi i Këshillit Organizues për nder të Ditës së Republikës së Kosovës, shpallja e njoftimit për regjistrimin e ekipeve, për garat e organizuara për nder të 17 Shkurtit, homazhe në vendlënie të dëshmorëve, organizimi i tryezës së historianëve të komunës së Rahovecit, orë historike në shkollë, seancë solemne, debat me të rinjtë “Rrugëtimi i Kosovës drejt lirisë”, si dhe koncert në bashkëpunim me Shkollën e Ulët të Muzikës “Faik Sylka”.
- Mbështetje në projektin e fituar të Shoqatës së Gruas “Hareja”. Projekti: Radio-Taxi për gratë në komunën e Rahovecit.
- Gjatë muajit shkurt të vitit 2019, pas shpalljes së “Thirrjes për aplikim”, në Sektorin për sport janë pranuar kërkesa të ndryshme për financim e mbështetje financiare,
 - Përpilimi i vendimeve dhe kontratave për subvencionim;
 - Nënshkrimi i kontratave dhe realizimi i pagesave, të cilat janë shqyrtuar nga komisioni i caktuar/ angazhuar nga Kryetari i Komunës.
 - Shuma totale që është shpenzuar për këto projekte ka qenë 82,000€.
- Në mars filloi zbatimi i projektit: Mësim rreth agronomisë përmes kursit të anglishtes, në bashkëpunim me Bibliotekën Rajonale në Prizren, ndërsa financohet nga Ambasada Amerikane. Të rinjtë u certifikuan nga Ambasada Amerikane.
- Përpilimi i rregullores së Palestrës "Mizahir Isma".
 - Është mbajtur debat publik për Draft Rregulloren rreth mënyrës dhe kushteve të shfrytëzimit të palestrës së sporteve “MIZAHIR ISMA” në Rahovec.
 - Diskutime në mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbledhje të Kuvendit Komunal, diskutime me klube sportive.
- Përgatitje rreth bazës ligjore për shpalljen e thirrjes për subvencionimin e OJQ-ve, në sektorin për Kulturë dhe Rini:
 - Shpallja e thirrjes për aplikim në sektorin e kulturës dhe rinisë.
 - Shuma totale që është ofruar për këto projekte ka qenë 19,100 €.
- Formimi i Këshillit Organizues të edicionit të 18-të të festivalit Anadrinia Jehon 2019.
 - Angazhime sistematike për organizimin e tryezës shkencore “Roli dhe rëndësia e festivalit të folklorit “Anadrinia jehon” në ruajtjen e vlerave kombëtare”, që u mbajt më 11 maj 2019.
 - Festivali i folklorit në Dejnë- (Komuna e Rahovecit - DKRS).
- Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës janë marrë këto vendime:
 - Caktimi i datës 7 dhjetor, Dita e bibliotekës komunale “Sulejman Krasniqi”.
 - Themelimi i çmimit letrar “Sulejman Krasniqi”.
- Përkujtimi i sallës së edukatës fizike, në Shkollën e Mesme “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe.
 - Projekt i DKRS-së. Financuar nga MKRS-së.
- Përkujtimi i Palestrës Sportive ‘Mizahir Isma’.
 - Projekt i DKRS-së. Financuar nga MKRS-së.
- Kemi përcjellur dhe organizuar shumë aktivitete përkujtimore në nderim të të rënëve për liri në territorin e komunës së Rahovecit: Homazhe, zbulim të pllakave përkujtimore, organizim të akademive përkujtimore, aktivitete sportive për nder të të rënëve etj.
- Për nder të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, janë shënuar disa aktivitete nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Zyrën për barazi gjinore, Shoqatën e pavarur të gruas “Hareja” dhe SHL-Kosova.

- Në 20 vjetorin e Ditës Ndërkombëtare të Poezisë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në komunën e Rahovecit organizoi Orë Poetike me nxënës të shkollave dhe poetët e komunës së Rahovecit.



Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Organizimi i tryezës shkencore për Ukshin Hotin, me temë: "Ukshin Hoti dhe mendimi politik modern shqiptar". Tryeza u mbajt në UPZ "Ukshin Hoti" në Prizren dhe u organizua në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit të Kosovës.
- "Java e Dëshmorëve". Organizimi i aktiviteteve sportive e përkujtimore. (OVL-UÇK).
- Përgatitja e specifikacionit të tenderit: "Pajisje me teknikë zërimi për Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj"-Rahovec.
- Organizime të aktiviteteve rinore në bashkëpunim me SHL-Kosova
- Në kuadër të Ditës Botërore të Librit, janë organizuar aktivitete të ndryshme nga DKRS-së, ndër to janë: Orë Letrare me nxënës të Shkollës së Mesme "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe, takim me mësuesin e Gjuhës Shqipe të Shkollës "Isa Boletini", takim ndërgjegjësues rreth librit, ku e mirëpritëm Shoqatën ETEA nga Prishtina. Në kuadër të takimit, rreth ndërgjegjësimit për librin, u ndanë 8 libra për lexuesit më aktiv të vitit.
- Kryetari i komunës z. Smajl Latifi bashkë me Ministrin e MKRS-së z. Kujtim Gashi, nënshkruan tri memorandume mirëkuptimi sipas të cilëve, kjo ministri do të financojë 2 milionë e 150 mijë në këto projekte:
 - Ndërtimin e stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë, në qytet, sipas standardeve të FIFA-s;
 - Ndërtimin e palestrës sportive në Krushë të Madhe;

– Ndërtimin e stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë, me standardet e Superligës së Kosovës, në Ratkoc.

- Organizimi i aktivitetit "Dita Olimpikë" 2019, në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, ku morrën pjesë rreth 400 fëmijë të vitit 2008, vit i shpalljes së pavarësisë.
- Dita e Sportit për Zhvillim dhe Paqe- organizimi i garave shkollore në volejball.
- Gara Komunale nga Shoqata e Peshkatarëve "Amur" në tri kategori, për pionierë, seniorë dhe juniorë, ku janë ndarë shpërblime për tri vendet e para fituese. Garat janë përkrahur financiarisht nga subvencionet e DKRS-së.
- Kolonia Ndërkombëtare e Artit ka realizuar ekspozitë, me pjesëmarrje të dhjetë vendeve të botës, dhe artistëve të komunës së Rahovecit. Ekspozita është përkrahur nga subvencione të DKRS-së.
- Shënimi i Ditës së Qendrës Kulturore "Mensur Zyberaj" me aktivitete të ndryshme: Formimi i Këshillit Organizues, takime të ndryshme, homazhe, ekspozitë, akademi solemne, program artistik.
- Festivali Mbarëkombëtar i muzikës klasike të talentëve të rinjë DO RE MI - Unë dhe Ti, organizuar nga Shkolla e Muzikës "Faik Sylka", mbështetur nga DKRS-së dhe sponsorë të tjerë.
- Takime lidhur me projektin e Bankës Botërore "Përfshirja e të Rinjve në Zhvillimin Ekonomik Lokal", i financuar nga Fondi Japonez për Zhvillim Social.
- Shënimi i Ditës së Çlirimit të Komunës së Rahovecit në bashkëpunim me Shoqëritë kulturore artistike, si dhe organizimi i aktiviteteve kulturore në Shtëpinë e Kulturës, seancë solemne, homazhe, orë historike, koncert festiv për fëmijë, gara në futboll të vogël "Turneu i lirisë".
- Poashtu, në kuadër të Ditës së Çlirimit, bashkëpunuam me DKA dhe me OJQ kulturore, për organizimin e Festivalit për Fëmijë. Në këtë program ishin të përfshirë rreth 10 shkolla fillore.
- Aplikim në thirrjen e MKRS-së për botimin e veprave të atdhetarit Sulejman Krasniqi dhe pasurimin e bibliotekave në komunën e Rahovecit.
- Për nder të Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe është mbajtur finalja e garave shkollore në volejball me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Rahovecit.
- Riaktivizimi i Klubit të Basketbollit të vajzave. 85 vajza të reja të interesuara për të marrë pjesë në Klubin e Basketbollit të Vajzave në Rahovec.
- Formimi i Klubit të Futsallit "Rahoveci".
- Janë përfundohen punë edhe te Kroji afër Sahat Kullës në Rahovec, në Zaqishtë si dhe kroji në Lagjën e Epërme. Është bërë funksionalizimi i ujit, vendosja e karriges, furnizim me material të nevojshëm, vendosja e kubzave rreth krojit, drunjë dekorativ etj

Përgjatë vitit 2019, synimi i Drejtorisë ishte realizimi i planit të veprimit, fuqizimi i organizatave rinore, promovimi i vullnetarizmit, realizimi i projekteve të cilat ishin të planifikuara nga buxheti i komunës dhe donatorëve të tjerë, zhvillimi i ngjarjeve kulturore, restaurimi i trashëgimisë kulturore, trajtimi me kujdes për shfrytëzimin e objekteve dhe institucioneve ekzistuese kulturore e sportive në komunën e Rahovecit.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

- Debate dhe takime me të rinj për të drejtat dhe obligimet e tyre
- Pjesëmarrja në debatin për rishikimin e ligjit për fuqizimin e rinisë (MKRS)
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në mënyrë që tju mundësoj dashamirësve të artit skenik, organizoj disa shfaqje teatrale në bashkëpunim me teatro të komunave tjera, ndër ta është edhe bashkëpunimi me Teatrin e Qytetit të Prizrenit, ku shfaqja "Iku Autobusi" u realizua në Shtëpinë e Kulturës, poashtu në bashkëpunim me Qendrën për Art dhe Komunitet – Artpolis u mbajt shfaqja teatrale "STIGMA -Kërko të Drejtën Tënde" në Shtëpinë e Kulturës në Rahovec dhe në Krushë të Madhe, dhe realizimi i shfaqjes "Dashuria në fund të Detit" nga Teatri i Kukullave Dodona – Prishtinë, me pjesëmarrje të rreth 200 fëmijëve.
- Përpjekje për konsolidimin e kryesisë së KF Rahoveci (gjendja ishte kaotike). Takime me kryetarin e komunës, me të interesuarit e rinjë, vizitë biznese për mbështetje të sportit, konsolidimi i kryesisë me emra të rinjë. Përgatitje për sezonin e ri të garave dhe angazhimet për tejkalimin e gjendjes së vështirë organizative.
- Gjatë kësaj periudhe, filloj projekti për mësimin e rregullave dhe kulturës në trafik, me moton: "Shpëto një jetë" nga "Engjujt e Trafikut" konkretisht një numër nënësish nga shkollat fillore. Projekti është realizuar falë bashkëpunimit me SHAM AK PZ.
- Mirëmbajtja e terreneve sportive dhe organizimi i ndeshjeve kampionale për klubet sportive të komunës së Rahovecit.
- Mbarëvajtje aktiviteteve sportive në palestrën "Mizahir Isma" dhe në terrenet tjera sportive.
- Marshimi me biçikleta, Rahovec Tour, organizim nga DKRS-së dhe grup të rinjesh.
- Furnizimi me libra i bibliotekës komunale "Sulejman Krasniqi".
- Organizime rreth përgatitjeve për festivalin, Hardh Fest 2020. Kjo periudhë, është karakterizuar me përgatitjet për festën tradicionale të rrushit "Hardh Fest". Kontributi i të rinjve të komunës së Rahovecit ka qenë i kënaqshëm, ndërsa janë bërë përpjekje për organizimin e mbarëvajtjes së kësaj feste
- Punimet në kuadër të projektit "Riparimi i Shtëpisë së Kulturës" ka vazhduar edhe përgjatë kësaj periudhe, ku një pjesë e punimeve të pjesës së jashtme janë përfunduar sipas projektit, pra sipas paramasës dhe parallogarisë.
- Përrurimi i fushës sportive në Lagjen e Epërme në Rahovec.



- Shënimi i 21 vjetorit të Epopesë së UÇK-së, me homazhe dhe akademi përkujtimore në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj".

- Kemi vazhduar me konservim dhe restaurim të Krojit në Nashpall. Që nga viti 2000 janë bërë përpjekje të zgjidhet çështja e ujit në këtë krua, por në 2019 investim ka komuna, është veshur kroji me gurë dekorativ, është zgjidhur problemi i ujit të pijshëm, është rregulluar trotuari përreth parkut, dhe janë vendosur rrethojat te parku i Krojit në Nashpall.
- Të rinjtë e komunës morrën pjesë në projektin “Kultura në Epokën Digjitale”.
- Është mbajtur konferenca “Trashëgimia dhe Mjedisi” në kuadër të Hardh Fest 2019. Si DKRS-së morrën pjesë në panel, ku diskutua rreth trashëgimisë kulturore e prodhuese si dhe mjedisit e rëndësishë së ruajtjes e mbrojtjes së tij.
- Organizim i sallorit me Rini: “Të rinjtë e Komunës së Rahovecit: Si të stimulohet aktivizmi rinor?”, i cili u mbajt në bashkëpunim me Demokracia Plus. Ku pika të diskutimit ishin: Orientimi në sektorin privat, shkollat profesionale, iniciativat rinore etj. Aktivizmi rinor luan rol të rëndësishëm në mënyrë që të rinjtë të ndryshojnë pozitivisht realitetin në të cilin po jetojnë.
- Konferencë “Roli dhe rëndësia e Trashëgimisë Kulturore dhe multikulturalizmit në komunën e Rahovecit”, u organizua në kuadër të planprogramit të HardhFest. Në konferencë morrën pjesë ekspert nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, përfaqësues të Institutit të Kosovës për mbrojtjet e monumenteve.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

- Aktivitete promovuese për pjesëmarrje të rinisë në jetën kulturore, rinore e sportive
- Hartimi i planit vjetor (2020) të punës dhe veprimit.
- Rregullimi i terreneve sportive ka vazhduar gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit. Është punuar në Opterushë, Kramovik dhe Dejnë, ndërsa janë përfunduar punimet në fushën sportive në Rahovec, e punimet janë duke vazhduar në vendet e lartcekura;
- Në Palestrën “Mizahir Isma” gjatë vitit 2019 janë zhvilluar shumë ndeshje në kampionat Aktivitete dhe stervitje të rregullta ditore e javore të KB Rahoveci, KB Ferronikeli, KH Rahoveci, KFS-Rahoveci, KFS-Rahoveci 2019, Grupmoshat KB-Rahoveci dhe KB-Rahoveci (Femrat).
- Riparimi i Monumenteve Kulturore Historike” - gjatë tërë vitit 2019;
- Organizimi i i Panairit të sportit (DKRS dhe KOK)
- Pajisja me teknikë zërimi për Shtëpinë e Kulturës “Mensur Zyberaj”;
- Dita e Bibliotekës “Sulejman Krasniqi” - është shënuar me aktivitete të ndryshme;
- Realizimi i dy shfaqjeve në Shtëpinë e Kulturës, të komedisë “Shkolla e natës” (DKRS-SHL);
- Organizimi i ekspozitës në Muzeun e qytetit, me temë: “Arsimi paralel në komunën e Rahovecit 1991-1999” - nga Lidhja e Historianëve “Ali Hadri” dhe DKRS;
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe, ku është bërë kubëzimi i oborrit rreth Kullës së Mahmut Pashës në Opterushë, vendosja e rrethojave, drunjve dekorativ, si dhe pjesë tjera rreth kullës. Ky objekt që daton nga viti 1850 është me



rëndësi për të kaluarën tonë, prandaj ruajtja dhe konservimi brenda kullës do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020;

- Në mënyrë që të kemi vetëdijësim sa më të madh, nga të rinjtë e komunës sonë, u mbajt debati me temë "Kultura në trafik" nga Prof. Dr. Beni Kizolti.
- Organizimi i ekspozitës në muzeun e qytetit, me temë: "Arsimi paralel në komunën e Rahovecit 1991-1999", nga Lidhja e Historianëve "Ali Hadri" dhe DKRS-së.
- Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" është shënuar me aktivitete të ndryshme, është shpallur konkursi për Cmimin "Sulejman Krasniqi", aktivitete në sallën e KK, ku është ndar cmimi "Sulejman Krasniqi", janë ndar mirënjohje për dhuruesit e librave, vizitë bibliotekës nga të vegjlit e SHFMU "Sadedin Hajda",
- Është nënshkruar kontrata për mirëmbajtjen dhe pastrimin e Palestrës "Mizahir Isma";
- Është realizuar projekti "Formati i Debatit Britanez", organizuar nga Kuvendi i të Rinjve të Rahovecit, dhe mbështetur nga DKRS.

Biblioteka "Sulejman Krasniqi"

- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore
 - Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare
 - Klasifikimi dhe katalogimi i librit
- Klasifikimi i librave sipas standardeve ndërkombëtare të KUD-it.
 - Mirëmbajtja dhe renditja e librave në mënyrë ndërkombëtare të bibliotekarisë.
 - Kemi bashkëpunuar me dashamir të librit: mësimdhënës, nxënës, shkrimtarë të komunës sonë dhe më gjerë, për ta ngritur vetëdijësimin e rinisë për lexim.
 - Po ashtu, kemi një bashkëpunim mjaft të mirë me Bibliotekën Kombëtare, Bibliotekën Universitare, Bibliotekën Regjionale "Ibrahim Rugova"- Gjakovë, Bibliotekën "Hivzi Sulejmani"- Prishtinë, Bibliotekën e Prizrenit etj.
 - Falë bashkëpunimit të mirë që kemi krijuar me institucione kulturore dhe autor të librave, biblioteka jonë është pasuruar edhe me tituj të rinj.
 - Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, konkretisht Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, ndau 236 tituj librash të rinjë degës së Bibliotekës në Krushë të Madhe.
 - Furnizimi i Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" me libra nga fondi i subvencionuar nga MKRS-së, donacion nga MKRS në vlerë prej 1500€.
 - Afro 80 libra i kemi pranuar nga donator të ndryshëm.

Pasurimi i fondit librar: 2361 ekzemplar Janar-dhjetor 2019

Fondi total i librave në bibliotekë: 17144 ekzemplarë.

Spektori i huazimit të librit:

- Janë regjistruar: 909 lexues, Sh. Fillore 731, Sh. Mesme 104, Student 29, Të tjerë 45.
- Vlera e pagesës: 882 euro.



- 1.1 Antarësime në bibliotekë për muajin Janar-dhjetor

Viti	Anëtar	Libra të lexuara	Student	Me pagesë	Gratis	Vajza	Djem
2019	909	7009	29	882	27	3988	3021

- 1.2 Tabela e lexuesve për muajin Janar- Dhjetor

Viti	Sh.Fillore	Sh.Mesme	Student	Të tjerë	Vajza	Djem	Gjithësej
2019	731	104	29	45	543	366	909

Përfundim

- *Gjatë vitit 2019, vlen të përmendet se Kryetari i Komunës Smajl Latifi ka rritur përkrahjen për organizata joqeveritare, në mënyrë që të rritet motivi i të rinjve që të përfshihen sa më shumë në punë vullnetare në OJQ tona, e që veprimtarinë e kanë në komunën e Rahovecit, me qëllim që të rinjtë të jenë pjesë e projekteve të ndryshme, Kryetari i Komunës nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi 5 vjeçar me organizatën ndërkombëtare për të rinjtë, YMCA in Kosovo. Projektet e kësaj organizate kanë për qëllim të zhvillojnë programe rinore për periudhën 5 vjeçare, si dhe të ndihmojnë dhe fuqizojnë aktivitetet rinore në Komunën e Rahovecit, me qëllim që komuniteti të përfitojë nga programet e OJQ-së GWY.*
- *Përveç aktiviteve të parapara për periudhën kohore janar-dhjetor 2019, DKRS-së është angazhuar edhe në aktivitete e punë të përditshme, pranimin dhe shqyrtimin e lëndëve, vizitë objekteve sportive, takime me klube dhe shoqata sportive, vizitë objekteve kulturore, takime merini, takimet e rregullta në kuadër të DKRS-së, përgatitje të raporteve javore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore, si dhe monitorimin e aktiviteteve sportive.*

Rahovec, 2020

Drejtoreshë e DKRS-së



Bjondina Kleqka